

L I G J
Nr.7790, datë 9.2.1994

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.753, DATË 13.1.1994 “PËR
PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE TË MALLRAVE TË IMPORTUARA NË
KUADRIN E PROJEKTEVE ME KREDI NE KUSHTE LEHTËSUESE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Të miratojë dekretin nr.753, datë 13.1.1994 “Për përjashtimin nga taksat doganore të mallrave të importuara në kuadrin e projekteve me kredi me kushte lehtësuese” me formulimin e nenit 1 si më poshtë:

Në nenin 3 të ligjit nr.7675 , datë 2.3.1993 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje: “Për të gjitha mallrat që importohen në kuadrin e kredive me kushte lehtësuese të akorduara nga organizmat ndërkombëtare e kombëtare të zhvillimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.778, datë 17.2.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.